



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1348 Prot.

Tiranë, më 06.11 2017

VENDIM Nr. 202, datë 31.10.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.12, datë 31.10.2017, pasi shqyrtoi Raportin e gërmimit arkeologjik të shtresës së sipërfaqësore (Kaminave) në Stacionin e Kompresorit ACS 03. Seman-Fier, në kuadër të *projektit të GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)*-subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e gërmimit arkeologjik të shtresës së sipërfaqësore (Kaminave) në Stacionin e Kompresorit ACS 03, Seman-Fier, në kuadër të *projektit të GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)*-subjekti "SPIECAPAG Shqipëria", realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Të gjitha kaminat e tjera, të cilat potencialisht do të zbulohen gjatë punimeve ndërtimore, të dokumentohen për të plotësuar hartën e shpërndarjes së tyre dhe rindërtimin e plotë të aktivitetit, brenda limiteve të gjurmës së prekur nga projekti.
3. Të rindërtohen dy tipe kryesore të kaminave të dokumentuara gjatë gërmimit të sipërpërmendur, me qëllim memorizimin e kësaj tradite për brezat e ardhshëm.
4. Të vijojnë punimet e ndërtimit të tubacionit të Linjës së gazjellësit TAP, duke u kryer ndjekja në mënyrë periodike ditore e punimeve të gërmimit, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, ndërmjet "SPIECAPAG Shqipëria", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të lidhur më parë për këtë zonë.
5. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al